



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1721/4 Prot.

Vlorë më, 24.06.2025

VENDIM

Nr. 68, datë 26.06.2025

PËR

**PËR MIRATIMIN E SHTOJCËS SË MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT
FINANCIAR SI PJESË E PANDARË E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË
STUDIMIT "MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI ARMATIMI ME PROFIL
MINOR NË AVIACION DHE NAVAL"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe referuar propozimit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore ardhur me shkresë Nr 1571, prot, datë 09.06.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 26.06.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtojcën për menaxhimin dhe administrimin financiar të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Armatimi me profil minor në Aviacion dhe Naval", si pjesë përbërëse dhe e pandarë e Rregullores së këtij programi studimi.
2. Shtojca përcakton mënyrën e menaxhimit të burimeve financiare, përgjegjësitë institucionale të palëve, ndarjen e kostove, financimin e aktiviteteve akademike, kërkimore dhe administrative të programit, si dhe raportimin dhe transparencën në përdorimin e fondeve.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. ASOC. DENADA SOTA

Adresa /Address: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++3552222288

Faqe 1 nga 1



Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1521 / Prot.

Vlorë më. 18 / 06 / 2025

RELACION

"Mbi shtojcën "Menaxhim dhe Administrimin financiar i programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Armatimi, me Profil Minor në Aviacion dhe Navale"

REKTORES SË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

PROF.DR. AURELA SALIAJ

Në zbatim të marrëveshjes së lidhur midis Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe Akademisë së Forcave të Armatosura, Tiranë, në lidhje me programin e përbashkët të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Armatimi, me Profil Minor në Aviacion dhe Navale" nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare pranë FSHTN-së, është përcjellë për miratim Shtojca 1 "Menaxhimi dhe administrimi financiar i programit të studimit", e cila do të jetë pjesë e rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Armatimi, me Profil Minor në Aviacion dhe Navale".

Bazuar në nevojat e identifikuara të cilat do të lindin për zbatimin e rregullores së programit të përbashkët të studimit, konstatohet domosdoshmëria për të rregulluar çështjet financiare të cilat nuk ishin parashikuar më parë, nëpërmjet hartimit të Shtojcës 1 në të cilën janë përcaktuar ndarjet e të ardhurave dhe shpenzimet që do të kenë institucionet respektive pas hapjes të programit të përbashkët të studimit.

Referuar Shtojcës 1, në të cilën janë parashikuar marrëdhëniet financiare, propozohet që miratimi i saj si pjesë e Rregullores së programin e përbashkët të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Armatimi, me Profil Minor në Aviacion dhe Navale" duhet të kalojë për miratim në organet kolegjiale të UV-së, Senat Akademik dhe Bordi i Administrimit.

Duke Ju folenderuar për bashkëpunimin!

PËRGJEGJËS SEKTORI

Julita SHABANI

Adresa / Address: Bulevardi Vlorë-Skelw
Tel. Fax ++355222248

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

DEKANI

Nr. 301/ Prot.

Vlorë, më 09/06/2025

Lënda:

Përcjellje për miratim shtojca "Menaxhim dhe Administrimi financiar i programit të studimit Masterit i Shkencave në "Inxhinieri Armatimi, me profil minor në Aviacion dhe Naval", pjesë e rregullores së programit të studimit të Masterit shkencor "Inxhinieri Armatimi, me profil minor në Aviacion dhe Naval"

REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
PROF. DR. AURELA SALIAJ

Bazuar në shkresën me Nr 298 Prot, Datë 09.06.2025 të Drejtuesit të Njesisë Bazë, po ju përcjellim për miratim shkresën "Përcjellje për miratim shtojca "Menaxhim dhe Administrimi financiar i programit të studimit Masterit i Shkencave në "Inxhinieri Armatimi, me profil minor në Aviacion dhe Naval", pjesë e rregullores së programit të studimit të Masterit shkencor "Inxhinieri Armatimi, me profil minor në Aviacion dhe Naval"

- Bashkëngjitur shkresa e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

DEKANI

Prof. Asoc. Miftar RAMOSAÇAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË DETARE

Prot

Vlorë 13/06/2025

Lënda: Përcillet për miratim shtojca "Menaxhimi dhe Administrimi financiar i programit të studimit "Master i shkencave në inxhinieri armatimi, me profile minore në aviacion dhe naval", pjesë e rregullores së programit të studimit të Masterit Shkencor "Inxhinieri armatimi, me profil minor në aviacion dhe naval"

Drejtuar: Prof. Asoc. Miftar RAMOSAÇAJ

DEKAN
I FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

I nderuar DEKAN,

Bashkangjitur po ju përcjellim për miratim shtojcën "Menaxhimi dhe Administrimi financiar i programit të studimit "Master i shkencave në inxhinieri armatimi, me profile minore në aviacion dhe naval", pjesë e rregullores së programit të studimit të Masterit Shkencor "Inxhinieri armatimi, me profil minor në aviacion dhe naval" për të vazhduar më tej procedurat e miratimit në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit të Universitetit 'Ismail Qemali', Vlorë.


Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I NJËSISË BAZË
Dr. Pëllumb CACAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
AKADEMIA E FROCAVE TË ARMATOSURA



Shtojca 1.

Menaxhimi dhe Administrimi financiar i programit të studimit "Master i shkencave në inxhinieri armatimi, me profile minore në aviacion dhe navale".

Bashkëpunimi midis palëve do të jetë i ndërsjelle, me ndihmën e ofruar njëri-tjetrit në kompetencat që zotërojnë në kryerjen e detyrave që lidhen me menaxhimin financiar dhe mbarëvajtjen e programit të studimit "Master i shkencave në inxhinieri armatimi, me profile minore në aviacion dhe navale".

- Përcaktimin e tarifës së shkollimit dhe miratimin e saj për secilin vit akademik në SA dhe BA të dy palëve.
- Të ardhurat që do krijohen nga tarifa e shkollimit do ndahen 50 % për AFA dhe 50 % për UV.
- Të ardhurat që do krijohen nga tarifa e aplikimit dhe regjistrimit do i mbeten UV për mbulimin e shpenzimeve administrative të programit.
- AFA do të mbulojë shpenzimet e personelit të saj akademik me kohë të plotë ose të pjesëshme si dhe shpenzimin e tarifës së licensimit dhe akreditimit të programit në masën 50 %.
- UV do të mbulojë shpenzimet e personelit të saj akademik me kohë të plotë ose të pjesëshme si dhe shpenzimin e tarifës së licensimit dhe akreditimit të programit në masën 50 %.
- Shpërblimi i personelit akademik i AFA, efektivë e joefektivë, që për nevoja të procesit mësimor, do të japin orë mësimi do përballohet nga AFA në përputhje me VKM Nr. 748, datë 11.06.2009, sipas kategorisë që ata kanë.
- Shpërblimi i personelit akademik i UV, efektivë e joefektivë, që për nevoja të procesit mësimor, do të japin orë mësimi do përballohet nga AFA në përputhje me VKM Nr. 748, datë 11.06.2009, sipas kategorisë që ata kanë.
- Shpenzimet për këtë program studimi do përballohen nga fondi i të ardhurave të 2 (dy) IAL – ve (AFA dhe UV).
- Uljen e tarifës deri në masën 50 % për personelin ushtarak ose civil të punësuar në FARSH ose MM ose që ka nënshkruar një kontratë punësimi me MM. Rimbursimi i kësaj tarife do bëhet nga fondet e buxhetit të shteti të ministrisë së mbrojtjes.

Kjo shtojcë është pjesë e pandarë e rregullores së programit Master i Shkencave në inxhinieri armatimi, me profile minore në aviacion dhe navale miratur me vendim SA të AFA nr. 28 datë 26.05.2025.

Kjo shtojcë hyn në fuqi me miratimin e Senatit dhe Bordit të Administrimit të AFA dhe UV.